AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:**
**"Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"**
**ofruar nga**
**Kolegji Profesional i Tiranës**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**
**Dr. Miranda HARIZAJ**
**Dr. Eda TABAKU**


**Korrik /2024**

**Tabela Përmbledhëse për Programin e Studimit me Karakter Profesional**

**"Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Profesional i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Programi i Studimit me Karakter Profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr.699, date 26.08.2015 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër QSHA Nr. 428, datë 17.12.2020 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA Nr.14, datë 30.03.2018 |
| 8 | Cikli i studimit: | - |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite / 4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 5 i KSHK |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (për vitin akademik 2022-2023) | 12 PAE / 4 PAK<br>Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton:<br>76 % PAE / 24 % PAK |
| 18 | Numri i studentëve (për një cikël të plotë studimi 2021 -2023): | V.A 2020-2021 : 18 studentë<br>V.A 2021-2022 : 10 studentë<br>V.A 2022-2023 : 14 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është një program studimi i ofruar nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, në Kolegjin Profesional të Tiranës.

Ky program studimi 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është licensuar me VKM Nr.699, date 26.08.2015 dhe hapur në vitin akademik 2017-2018.

Programi i studimit dy-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, dhe me kohëzgjatje normale.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" realizohet në dy vite akademike, me 4 semestra dhe në përfundim të këtij programi studimi me karakter profesional lëshohet "Diplomë Profesionale". Diploma e këtij programi studimi është e regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me Urdhër të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, QSHA, Nr. 428, datë datë 17.12.2020.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është një program studimi i nivelit 5 referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është akreditruar për here të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.14 datë 30.03.2018 nga ASCAL për një periudhë 5 vjeçare.

Ky program studimi me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është në proces riakreditimi.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar nga ASCAL që ka në përbërje: Dr. Miranda HARIZAJ dhe Dr. Eda TABAKU. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Znj. Anilda BEQIRAJ.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Kolegji Profesional i Tiranës, në kuadër të procedurës së aplikimit për riakreditim të programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", e përbërë nga 107 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datë 16 – 17 Tetor 2023, në institucion sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët.

Grupi i ekpertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kritereve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Kolegji Profesional i Tiranës.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.14 datë 30.03.2018 nga ASCAL me vlerësim pozitiv, për një periudhë 5 vjeçare me rekomandimet e mëposhtme:

**I. Rekomandimet në zbatim të Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.14, datë 30.03.2018, janë si vijon:**

1. *Të pasurohet fondi i bibliotekës me tekste e literaturë që mbulojnë plotësisht modulet e këtij programi studimi;*
2. *Të rritet gama e Institucioneve të bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtare për të mundësuar mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik;*

**II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

**Në lidhje me rekomandimin 1.** Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit të IAL dhe vizitën në bibliotekën e institucionit u evidentua se institucioni ka pasuruar bibliotekën me literaturë fizike në funksion dhe të programit të studimit, kryesisht në gjuhën angleze. KPT ka ofruar bibliotekën e hapur online me materiale mësimore dhe kërkimore, open source, e cila mund të aksesohet dhe në faqen zyrtare të KPT nga kushdo. Në këtë bibliotekë online - OER-Open Educational Resources gjenden një numër i madh librash, revistash shkencore dhe video tutoriale të cilat ofrohen nga universitetet dhe organizatat kudo në botë, nën një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimin dhe rishpërndarjen nga të tjerët pa kufizime, si dhe ofron libraritë online ku institucioni është abonuar. Në të njëjtën kohë KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me UET duke siguruar kështu një gamë akoma më të gjërë të literaturës fizike dhe akses në librarinë online http://europs-services.ubt-uni.eu/login.php, në funksion dhe të këtij programi studimi. **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

**Në lidhje me rekomandimin 2.** Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit të IAL dhe vizitën në IAL, GVJ evidenton se KPT ka rritur dhe diversifikuar gamën e institucioneve ndërkombëtare bashkëpunuese nëpërmjet projekteve fituese të Bashkimit Europian, të cilat mundësojnë rritjen e kapaciteteve të IAL, mbështesin personelin akademik dhe studentët me trajnime, mobilitete, etj si psh:

1. Programi Erasmus+ për zhvillimin e modulit Jean Monnet, "Të përvetësojmë Agjendën Digjitale të Bashkimit Europian: Sfidat dhe mundësitë e transformimit digjital në Shqipëri";
2. "Inxhinierizimi i modernizimit të kurrikulës së energjisë së rinovueshme në universitetit shqiptare"- ENGINE, projekt që financohet nga Programi Erasmus+ CBHE i Bashkimit Europian;

3. MoVET -Mobility in Europe for VET, projekt i përzgjedhur nga Komisioni Europian, nën drejtimin e ENAIP NET, ku marrin pjesë Universite dhe Institucione kërkimore nga Greqia, Gjermania, Spanja, Belgjika, Italia dhe 6 IAL partnere nga Ballkani Perendimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi); **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

**Vlerësimi i Programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Kolegji Profesional i Tiranës si Institucion jo publik i Arsimit të Lartë, ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, që mbështeten dhe në vizionin, misionin dhe objektivat strategjike të KPT-së dhe dokumentet të KPT.<br>**Evidencë 3 Statuti KPT, neni 6**<br>**Evidencë 7 – Strategjia 2021 -2025 dhe Evidencë 7.1 – Strategjia 2015 -2020** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | KPT ofron programe të studimeve me karakter professional, niveli 5 sipas kornizës së kualifikimeve shqiptare, të shprehura qartë në statutin dhe rregulloren e tij.<br>Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e IAL, qëllimet dhe misionin e IAL, si dhe fushën e veprimtarisë.<br>Si një program në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.<br>**Evidencë 3 Statuti KPT**<br>**Evidencë 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hartuar dhe ofrohet në zbatim të strategjisë për zhvillim, me fushat e drejtimet akademike të tij, si dhe në mbështetje të objektivave afatgjatë të veprimtarisë mësimore të KPT "Të pergatisë teknikë të lartë dhe profesionistë". |

| | |
|---|---|
| e drejtimet akademike të tij. | **Evidencë 7 Strategjia 2021 -2025**<br><br>**Evidencë 7.1 Strategjia 2015 -2020** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit harton "Planin strategjik për zhvillimin e programit" me qëllim ruajtjen e koherencës së kurrikulës së programit me njohuritë dhe zhvillimet më të fundit në fushën e studimit, aftësimin profesional në drejtimet praktike më të reja dhe me përmbushjen e kërkesave të tregut të punës, kjo në përputhje me njohuritë e fituara në fushën e studimit, kërkesave të tregut të punës dhe Strategjinë e Zhvillimit të KPT-së.<br><br>Për hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe planit mësimor, KPT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse. Për këtë program studimi nuk është kryer studim i mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit.<br><br>*GVJ rekomandon që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të kryejë një studim të mirëfilltë në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për tiu përshtatur kërkesave dhe nevojave të reja të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.*<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja e Kolegjit Profesional te Tiranes, neni 14, pika 5.**<br><br>**Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit "TIK"**<br><br>**Evidenca 31 Takimi me bizneset.** |
| **Kriteri 5.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Nga vlerësimi i dokumentacionit, vizitës në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, GVJ konstaton se KPT ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi". KPT përbëhet nga 2 departamente:<br><br>**1.** Departamenti i Teknologjisë së Informacionit – 9 PAE dhe 14 PAK në vitin akademik 2022-2023, nga të cilët 5 janë me grada shkencore dhe tituj akademik;<br><br>**2.** Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara. – 10 PAE dhe 11 PAK në vitin akademik 2022-2023, nga të cilët 2 janë me grada shkencore dhe tituj akademik;<br><br>;\' |

| | |
|---|---|
| | **Evidencë 6.1 Të dhënat e stafit në vite**<br><br>**Evidencë shtesë Ngarkesa vjetore e realizuar, viti akademik 2022 - 2023 TIK**<br><br>**Evidencë 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 6.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, që ofron këtë program studimi.<br><br>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ofron dhe 4 programe të tjera të arsimit professional pas arsimit të mesëm. Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ofron 5 programe të ndryshme të arsimit professional pas arsimit të mesëm.<br><br>**Evidencë 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve**<br><br>Kodifikimi për këtë program studimi i propozuar me shkresë MASH është 52PPS/00612, por sipas përcaktimeve të VKM Nr.310, datë 11.05.2022 kodi i duhur për këtë program studimi është: 52PP0612S. |
| **Konkluzione** | - *Kolegji Profesional i Tiranës si Institucion publik i Arsimit të Lartë, ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.*<br><br>- *Programi i studimit me karakter professional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hartuar dhe ofrohet në përputhje në përputhje me Statutit dhe Rregulloret e IAL, qëllimet dhe misionin e IAL, fushën e veprimtarisë së tij, si dhe është hartuar dhe ofrohet në zbatim të strategjisë për zhvillim.*<br><br>- *Programi i studimit është bashkëkohor, në përputhje me nevojat e tregut të punës në vend dhe jashtë.*<br><br>- *Për hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe planit mësimor, KPT-ja konsultohet me përfaqesues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse.*<br><br>- *GVJ rekomandon që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të kryejë një studim të mirëfilltë në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për tu përshtatur kërkesave dhe nevojave të reja të tregut* |

| | |
|---|---|
| | *kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.*<br>- *KPT ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit me karakter profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi".*<br>- *Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | KPT ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit me karakter professional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi".<br>**Evidencë 3.1 Organigrama**<br>**Evidencë 4 Rregullorja KPT**<br>**Evidencë 17.1 Rregullore Tutoriati**<br>**Evidencë 13.1 Rregullore NjSBC**<br>**Evidencë 32 RREGULLORE E SEKRETARISE MESIMORE**<br>**Evidencë 34.2 Rregullorja e Bibliotekës** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me | GVJ evidenton se KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me IAL në vend dhe jashtë si Universiteti Politeknik i Tiranës, UAMD, Instituti Kanadez i Teknologjisë, Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti i Thesalisë, si dhe me kompani private brenda dhe jashtë |

| | |
|---|---|
| institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | vendit, në funksion dhe të këtij programi studimi.<br>*GVJ evidentoi se disa nga marrëveshjet aktuale me IAL-të u ka përfunduar afati ose janë të hershme.*<br>**Evidencë 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet**<br>**Evidencë 10.1 Aktiviteti Konferenca e Rektorëve**<br>**Evidencë 10.2 MoU_UTh** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në USH, GVJ konstaton se IAL ka nënshkruar marrëveshje me institucione apo kompani të biznesit në funksion dhe të praktikave profesionale. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet.<br>**Evidencë 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet**<br>**Evidencë 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit**<br>**Evidencë 11 Lista e Projekteve**<br>**Evidencë 5.2 Raporti i praktikave**<br>**https://kolegjiprofesional.edu.al/partneret-tane/** |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, përgjegjës për programin e studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në mënyrë periodike harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ku paraqet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm dhe përfitimit në kuadër të procesit mësimor dhe formues.<br>**Evidencë 5.2 Raporti i praktikave**<br>**Evidencë 36 Raporti vjetor** |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KPT dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave ne institucion, GVJ konstaton se Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve është struktura mbështetëse që informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" për tregun e punës. Studentët janë udhëzuar dhe kanë përfituar nga marrëveshjet e IAL për praktika mësimore dhe janë ftuar dhe në aktivitetet e realizuara si në |

| | |
|---|---|
| | rastin e bashkëpunimit për praktikat mësimore dhe aktivitetet e tjera të organizuara nga IAL në funksion dhe të këtij program studimi sic janë panairi i punës, hackathon, Sondazhi i Alumnit. Në mënyrë të veçantë për ata studentë të këtij programi studimi që nuk janë të punësuar janë informuar në mënyrë të vazhdueshme për mundësi të ndryshme punësimi.<br>**Evidencë 6.5 NASA Hackathon konkurse**<br>**Evidencë 44 Thirrje Njoftime Punësimi**<br>**Evidencë 18 Vizita Praktika në terren**<br>**Evidencë 18.1 Panairi i punës ne KPT**<br>**Evidencë 24.4 Panairet Work and Study Panairi House of Europe.**<br>**Evidencë 12 Sondazhi Alumni**<br>**Evidencë 20 KPT HUB** |
| **Konkluzione** | - *KPT ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.*<br>- *GVJ evidenton se KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me IAL, si dhe me kompani private brenda dhe jashtë vendit, në funksion dhe të këtij programi studimi.*<br>- *IAL ka nënshkruar marrëveshje me institucione apo kompani të biznesit në funksion dhe të praktikave profesionale. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet.*<br>- *Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, përgjegjës për programin e studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në mënyrë periodike harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.*<br>- *Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve është struktura mbështetëse që informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *për tregun e punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe strukturë të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në KPT është ngritur dhe funksionon struktura autonome në strukturën organizative të KPT, në nivel institucional Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.<br><br>**Evidencë 13 Vendim i ngritjes së NjSBC**<br><br>KPT ka hartuar në funksion të punës të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.<br><br>**Evidencë 13.1 Rregullore NjSBC** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuarnjë strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | KPT ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Informacion i plotë për funksionimin e Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë jepet në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Në përbërje e NJSBC për KPT ka dhe një student.<br><br>**Evidencë 13.1 Rregullore NjSBC**<br><br>**Evidencë 13 Vendim i ngritjes së NjSBC** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i | KPT përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. DTI që mbështet këtë program studimi, bën raportim vjetor të brendshëm në lidhje dhe për të siguruar cilësinë e programit të studimit. |

| | |
|---|---|
| cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | KPT ka caktuar koordinatorët/tutorët e programeve të studimit, për programet që mbështet. Koordinatori/Tutori i programit të studimit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në KPT. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.<br>**Evidencat 17.1 Rregullore Tutoriati**<br>**Evidenca 17 TUTORIATI KESHILLIMI AKADEMIK**<br>**Evidencë 9 Mbledhje Rektorati Departamenti Asamble** |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira. | KPT përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet, që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. GVJ konstaton se DTI organizon takime të hapura me studentët me qëllim mbledhjen e shqetësimeve dhe problematikave që kanë për ti përmirësuar dhe zgjidhur problematikat e tyre, për mësimëdhënien, praktikat mësimore, anketimet e studentëve, etj. KPT mbështet dhe bën promovime për të evidentuar dhe promovuar arritjet më të mira të personelit akademik dhe studentëve.<br>**Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT**<br>**Evidencë 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve**<br>**Evidencë 11.5 Thirrje per pjesemarrje ne projekte për stafin**<br>**Evidencë 6.5 NASA Hackathon konkurse**<br>**Evidencë 20 KPT HUB**<br>**Evidencë 6.6 Raporti i cilesise se studenteve** |
| **Konkluzione** | - *Në KPT është ngritur dhe funksionon struktura autonome në strukturën organizative të KPT, në nivel institucional Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.*<br>- *KPT ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm* |

| | |
|---|---|
| | *të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.*<br>- *KPT përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. DTI që mbështet këtë program studimi, bën raportim vjetor të brendshëm në lidhje dhe për të siguruar cilësinë e programit të studimit.*<br>- *Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1**<br><br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | GVJ konstaton se struktura e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar, |

| | |
|---|---|
| | dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke pasur shmangje të vogël në totalin vjetor prej 60 kreditesh, përkatësisht 61 kredite në vitin e parë dhe 59 kredite në vitin e dytë dhe me përqindjen sipas secilit tip të komponentit mësimor:<br><br>• Lëndët bazë **12.5** %, kur duhet (10% - 15%) kredite;<br><br>• Lëndët karakterizuese 50%, kur duhet (45–55 %) kredite;<br><br>• Lëndët ndërdisiplinore **20 %,** kur duhet (5 % - 15%) kredite;<br><br>• Lëndët plotesuese 11.7%, kur duhet (10% - 15%) kredite;<br><br>• Detyrimet përmbyllëse **5.8** %. kur duhet (3% - 5%) kredite;<br><br>U evidentuan shmangie në përqindjen e lejuar për lëndët ndërdisiplinore dhe detyrimet përmbyllëse.<br><br>*GVJ rekomandon të përcaktohen kreditet sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, brenda % së lejuar për të gjithë komponentët mësimor.*<br><br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale. | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme teorike dhe praktike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimi si administrator dhe mirëmbajtës sistemi, rrjeti dhe programim, etj. GVJ konstaton se këto objektiva përmbushen dhe rezultojnë të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit, planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve. Në këtë program janë të përcaktuara qartë objektivat për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.<br><br>Ky program studimi ka mision të përgatisë aftësitë dhe kompetencat kryesore profesionale në:<br><br>• Krijimin e infrastrukturave të rrjetit si dhe mirëmbajtjen e tyre;<br><br>• Ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e serverëve. (Virtualizimin e serverëve, Domain Controller, Active |

| | |
|---|---|
| | Directory etj);<br>• Instalimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e softuer dhe harduer në një organizatë;<br>• Ndërtimin e sistemeve të monitorimit për infrastrukturën e IT;<br>• Konfigurimet e të gjitha pajisjeve kompjuterike dhe implementimin e teknologjive të reja;<br>• Ndërtimin e procedurave të një organizatë dhe aplikimin e politikave për pajisjet IT;<br>• Diagnostikimin e problemeve kompjuterike, monitorimin e sistemeve të përpunimit kompjuterik si dhe testimin në pajisjet dhe programet kompjuterike të rrjetit;<br>• Ndërtimi i teksteve elektronike, softuer-ve mësimore, e-mail, programeve mësimit në distancë, produkteve multimediale (transmetimet video, audio, telefonia dhe telekomunikacioni);<br>• Implementimin e teknikave të sigurisë së informacionit në infrastrukturën IT;<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT**<br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR**<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. | Ky program studimi ka mision të përgatisë aftësitë dhe kompetencat kryesore profesionale në:<br>• Krijimin e infrastrukturave të rrjetit si dhe mirëmbajtjen e tyre;<br>• Ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e serverëve. (Virtualizimin e serverëve, Domain Controller, Active Directory etj);<br>• Instalimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e softuer dhe harduer në një organizatë;<br>• Ndërtimin e sistemeve të monitorimit për infrastrukturën e IT;<br>• Konfigurimet e të gjitha pajisjeve kompjuterike dhe implementimin e teknologjive të reja;<br>• Ndërtimin e procedurave të një organizatë dhe aplikimin e |

| | |
|---|---|
| | politikave për pajisjet IT;<br>• Diagnostikimin e problemeve kompjuterike, monitorimin e sistemeve të përpunimit kompjuterik si dhe testimin në pajisjet dhe programet kompjuterike të rrjetit;<br>• Ndërtimi i teksteve elektronike, softuer-ve mësimore, e-mail, programeve mësimit në distancë, produkteve multimediale (transmetimet video, audio, telefonia dhe telekomunikacioni);<br>• Implementimin e teknikave të sigurisë së informacionit në infrastrukturën IT;<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT**<br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR**<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirëdhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Programi i studimit ka 10 kredite për realizimin e praktikës profesionale, në semestrin e IV-ërt, në vitin e dytë. Programi i studimit mbyllet me mbrojtjen e diplomës/provim formimi, e cila ka 7 kredite.<br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR** |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka të përcaktuar formën e organizimit, pranimin e studentëve dhe financimin në aktet rregullatore, në zbatim dhe në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me programe të tjera, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë si në Universiteti "Barleti", UMSH, KUB, UAMD. |

| | |
|---|---|
| ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | **Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR**<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Procesi i kodifikimit për këtë program studimi është në proces. Kodifikimi për këtë program studimi i propozuar me shkresë MASH është 52PPS/00612, por sipas përcaktimeve të VKM Nr.310, datë 11.05.2022 kodi i duhur për këtë program studimi është: 52PP0612S.<br>**Evidenca 8 Shkresa MAS për kodifikimin e programeve** |
| **Konkluzione** | - *GVJ konstaton se struktura e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).*<br>- *GVJ rekomandon të përcaktohen kreditet sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, brenda % së lejuar për të gjithë komponentët mësimor.*<br>- *Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka të përcaktuar formën e organizimit, pranimin e studentëve dhe financimin në aktet rregullatore, në zbatim dhe në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet | Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit 08, datë 27.01.2023, që e akrediton institucionin për 5 vite akademike. KPT ka në përbërje:<br>KPT përbëhet nga 2 departamente: |

| | |
|---|---|
| akademike vlerësimin dhe akreditimin. | • Departamenti i Teknologjisë së Informacionit – 9 PAE dhe 14 PAK në vitin akademik 2022-2023;<br>• Viti akademik 2018-2019, 13 PAE (2 Prof Dr, 10 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2019-2020, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2020-2021, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2021-2022, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2022-2023, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND).<br>2 Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara – 10 PAE dhe 11 PAK në vitin akademik 2022-2023.<br>Përveç programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", DTI ofron studime dhe në 4 programe të tjera profesionale. Përgjegjësitë e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin, rregulloren e KPT dhe rregulloren specifike të programit të studimit. Drejtuesi i DTI mban titullin akademik "Prof.Dr".<br>KPT në vitin akademik 2022-2023, ka në përbërje të tij 44 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 19 janë personel akademik efektiv (PAE), dhe 25 personel akademik me kontratë (PAK).<br>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2022-2023:<br>1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit:<br>9 PAE, ndër të cilët 2 me tituj / grada; 14 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;<br>2. Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara:<br>10 PAE, ndër të cilët 2 me tituj / grada; 11 PAK.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |

| | |
|---|---|
| | **Evidenca 5.5 SYLLABUS**<br>**Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite**<br>**Evidenca 29.4 Vendim Rektorati për miratimin e stafit me kohë të pjesshme** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit 08, datë 27.01.2023, që e akrediton institucionin për 5 vite akademike. KPT ka në përbërje:<br>KPT përbëhet nga 2 departamente:<br>• Departamenti i Teknologjisë së Informacionit – 9 PAE dhe 14 PAK në vitin akademik 2022-2023;<br>• Viti akademik 2018-2019, 13 PAE (2 Prof Dr, 10 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2019-2020, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2020-2021, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2021-2022, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2022-2023, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND).<br>3 Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara – 10 PAE dhe 11 PAK në vitin akademik 2022-2023.<br>Përveç programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", DTI ofron studime dhe në 4 programe të tjera profesionale. Përgjegjësitë e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin, rregulloren e KPT dhe rregulloren specifike të programit të studimit. Drejtuesi i DTI mban titullin akademik "Prof.Dr".<br>KPT në vitin akademik 2022-2023, ka në përbërje të tij 44 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 19 janë personel akademik efektiv (PAE), dhe 25 personel akademik me kontratë (PAK).<br>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2022-2023:<br>3. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit: |

| | |
|---|---|
| | 9 PAE, ndër të cilët 2 me tituj / grada; 14 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;<br>4. Departamenti i Elektro - Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara:<br>10 PAE, ndër të cilët 2 me tituj / grada; 11 PAK.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT**<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS**<br>**Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite**<br>**Evidenca 29.4 Vendim Rektorati për miratimin e stafit me kohë të pjesshme** |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | KPT në zbatim dhe të rregullores përkatëse të tutoriatit/ keshillimit akademik ka caktuar koordinatorët/tutorët e programeve të studimit, për programet që mbështet. Koordinatori/Tutori i programit të studimit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në KPT.<br>DTI njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës dhe për ecurinë praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br>**Evidenca 17 TUTORIATI KESHILLIMI AKADEMIK**<br>**Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati** |
| **Konkluzione** | - *Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit 08, datë 27.01.2023, që e akrediton institucionin për 5 vite akademike.*<br>- *GVJ konstaton njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore minimale për numrin dhe kualifikimin grada/tituj të personelit akademik sipas përcaktimeve ligjore.*<br>- *GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit nuk ka të angazhuar për programin e studimit personel ndihmës akademik të dedikuar për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.*<br>- *DTI njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, ka* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës dhe për ecurinë praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.3**<br><br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | DTI si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të shprehura në Rregulloren e KPT, Kreu VII "Studime Profesionale" dhe rregulloren e programit të studimit, Neni 3 "Struktura e Programit të Studimit".<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.<br><br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit me karakter professional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, të shprehura qartë në rregulloren e KPT dhe rregulloren e programit të studimit.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE** |

<table>
<tr><td colspan="1"></td><td colspan="4">STUDIMIT</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td><td colspan="4">Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me shtojcën e miratuar nga VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, Shtojca 3.<br><br>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës.<br><br>GVJ rekomandon që të azhornohet literatura në syllabuset e lëndëve, pasi duhet të jetë edhe të pasurohet edhe me botime të 5 viteve të fundit.<br><br>Evidenca 5.5 SYLLABUS</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</td><td colspan="4">Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të cdo viti akademik. Aktualisht ka përmirësime të disa syllabuseve të lëndëve, por nuk ka ndryshime në planin mësimor të programit të studimit.<br><br>Evidenca 4 Rregullorja KPT<br><br>Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit “TIK”<br><br>Evidenca 5.5 SYLLABUS</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">DTI si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.<br><br>GVJ rekomandon që të azhornohet literatura në syllabuset e lëndëve, pasi duhet të jetë edhe të pasurohet edhe me botime të 5 viteve të fundit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td></td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi II.4<br><br>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</td><td>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për studime të mëtejshme apo punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. Në kurrikulën e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si lëndë dhe veprimtari formuese.<br><br>Evidenca 5.5 SYLLABUS</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</td><td>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se disa lëndë të rëndësishme për realizimin e objektivave dhe rezultateve të programit të studimit, në fushën e programit të studimit janë: “Rrjeta e kompjuterave”, “Teknikat dhe gjuhët e programimit”, “Web design”,” Administrim sistemesh”, “Database 1/ Moduli JM: Dixhitalizimi në sektorin privat”, “Administrim rrjeti” dhe “Siguria e sistemeve informatike”.<br><br><u>Ky program ka nevojë të përditësohet në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat aktuale të tregut të punës, për të cilin duhet të kryhet një studim i mirëfilltë i tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës.</u><br><br>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 4 semestrat e realizimit të programit është e balancuar për çdo semestër.<br><br>Ngarkesa mësimore javore në auditor është:<br><br>1. Semestri I 14 javë 23.5 orë;<br><br>2. Semestri II 14 javë 23.5 orë;<br><br>3. Semestri III 15 javë 23.5 orë;</td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><th>Viti/Semestri</th><th>Leksion (kredite)</th><th>Seminar (kredite)</th><th>Laborator (kredite)</th><th>Forma të kontrollit të vazhdueshëm/Seanca të praktikave lëndore në auditor/Praktikë profesionale(kredite)</th></tr>
<tr><td>Viti 1/Sem.1</td><td>13</td><td>14</td><td>4</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Viti 1/Sem.2</td><td>15</td><td>10</td><td>5</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Viti 2/Sem.1</td><td>15/16</td><td>10/8</td><td>5/4</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Viti 2/Sem.2</td><td>6</td><td>4</td><td>2</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>49/50</td><td>38/36</td><td>16/15</td><td>10</td></tr>
</table>
Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR
Evidenca 5.5 SYLLABUS
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</td>
<td>
Programi i studimit me karakter professional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", sic paraqitet dhe ne tabelën ne kriterin 2 të këtij standarti pergjithsësisht ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre, praktike.
Rreth 23 % e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Në këtë % është marrë në konsideratë numri i krediteve laborator dhe praktikë profesionale 26 Kredite/113 kredite (pa diplomën).
<u>GVJ rekomandon që në planin mësimor për këtë program studimi të rritet numri i krediteve për laboratorët në disa lëndë, që janë shumë të rëndësishëm për këtë program studimi me karakter profesional,</u> si për shembull në lëndët" Teknikat dhe Gjuhët e Programimit", "Web Design", "Administrim Rrjeti" dhe "Siguria e Sistemeve Informatike".
Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR
Evidenca 5.5 SYLLABUS
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit</td>
<td>Në këtë program studimi gjatë 2 viteve akademike zhvillohen 1343 orë mësimore në auditor përkatësisht 343 orë leksion, 456 orë seminare, 336 orë ushtrime dhe laboratore, 210 orë praktikë</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studieve. | mësimore dhe 1706 orë mësimore studim individual, të pa specifikuara për çdo veprimtari mësimore. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët e programit të studimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raporti midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, tranferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e informatikës. Për vitet akademike 2021-2023, në këtë program studimi nuk ka pasur transferime por kanë përfituar nga mobiliteti i projekteve Erasmus+.<br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR**<br>**Evidenca shtesë 38 Praktika Connected through Mobility**<br>**Evidenca 21.1 Mobilitetet**<br>**Evidenca 11 Lista e Projekteve** |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabuset e programit të studimit. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. GVJ konstaton se syllabuset kanë të përfshirë literaturën bazë dhe e rekomanduar, *por kjo literaturë nuk është e përditësuar në të gjitha syllabuset*.<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 6.** Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit. | Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi e vlerësimi i tyre në profesion realizohet dhe mbështetet nga KPT dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit për këtë program studimi.<br>Në rregulloren e praktikave profesionale të KPT jepet në mënyrë të detajuar se si do të zhvillohet praktika profesionale.<br>**Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale**<br>**Evidenca 5.2 Raporti i praktikave** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e | Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, në përputhje me nivelin 5 të KSHK, *por duhet të përmirësohet në përputhje me rezultatet e studimit të tregut të punës, në mënyrë që të mundësojë punësimin e studentëve sipas pritshmërive e kërkesave të tregut të punës.*<br>**Evidenca 5.3 PLANI MESIMOR** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. | | | | |
| **Konkluzione** | - *GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për studime të mëtejshme apo punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë.*<br>- *Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre, praktike.*<br>- *GVJ rekomandon që në planin mësimor për këtë program studimi të rritet numri i krediteve për laboratorët për disa lëndë, që janë shumë të rëndësishëm për këtë program studimi me karakter profesional.*<br>- *Në KPT në rregulloren e praktikave profesionale, jepet në mënyrë të detajuar se si do të zhvillohet praktika profesionale.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | KPT në zbatim të strategjisë së IAL synon të mundësojë ndërtimin e urave të reja të komunikimit e shpërndarjen e informacionit në mënyrë sa më efektive me institucionet qëndrore dhe lokale, organizata dhe institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile, por edhe partnerë të tjerë të mundshëm. KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës, në vend dhe jashtë vendit. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e drejtëpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik. |

| | |
|---|---|
| | Në KPT, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores në KPT. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:<br>1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet çdo semestër para provimeve;<br>2. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 7 Strategjia 2021 -2025**<br>**Evidenca 4 Rregullorja e Kolegjit Profesional te Tiranes, neni 14, pika 5.**<br>**Evidenca 23 VENDIMET SA**<br>**Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit "TIK"**<br>**Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit**<br>**Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet**<br>**Evidenca 11 Lista e Projekteve**<br>**Evidenca 31 Takimi me bizneset.**<br>**24.4 Panairet Work and Study Panairi House of Europe.**<br>**Evidenca 15 Formularet e vlerësimit Studente**<br>**Evidenca 16 Fokus Grupe** |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në KPT studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores në KPT. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:<br>3. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet çdo semestër para provimeve;<br>4. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.<br>Për hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe planit mësimor, KPT-ja konsultohet dhe me përfaqesues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse. Për këtë program studimi nuk është kryer studim i mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit. |

| | |
|---|---|
| | *GVJ rekomandon që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të kryejë një studim të mirëfilltë në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për tiu përshtatur kërkesave dhe nevojave të reja të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.*<br>**Evidenca 4 Rregullorja e Kolegjit Profesional te Tiranes, neni 14, pika 5.**<br>**Evidenca 23 VENDIMET SA**<br>**Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit "TIK"**<br>**Evidenca 15 Formularet e vlerësimit Studente**<br>**Evidenca 16 Fokus Grupe** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private. | Për hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe planit mësimor, KPT-ja në aktivitetet e organizuara konsultohet dhe me përfaqesues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse. GVJ konstaton që për këtë program studimi nuk është kryer studim i mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit.<br>*GVJ rekomandon që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të kryejë një studim të mirëfilltë në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për tiu përshtatur kërkesave dhe nevojave të reja të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.*<br>**Evidenca 7 Strategjia 2021 -2025**<br>**Evidenca 4 Rregullorja e Kolegjit Profesional te Tiranes, neni 14, pika 5.**<br>**Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit "TIK"**<br>**Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit**<br>**Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet**<br>**Evidenca 11 Lista e Projekteve**<br>**Evidenca 31 Takimi me bizneset.**<br>**24.4 Panairet Work and Study Panairi House of Europe.** |
| **Konkluzione** | - *KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës, në vend dhe jashtë vendit. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *drejtpërdrejta, por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik.*<br>- *Në KPT, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së IAL.*<br>- *Për hartimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe planit mësimor, KPT-ja konsultohet me përfaqesues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse. Për këtë program studimi nuk është kryer studim i mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Mbështetur në rregulloren e KPT dhe vizites në Institucion GVJ konstaton se ngarkesa në auditor e studentëve është e përcaktuar në syllabuset e lëndëve.<br>Në përbërje të së ciles ka:<br>• Leksione<br>• Ushtrime<br>• Laborator<br>• Praktike<br>Në planin mësimorë të programit të studimit përshihen gjithashtu edhe: |

| | |
|---|---|
| | • Leksionet interactive<br>• Zhvillimi i konsultimeve për cdo lëndë në auditor<br>Stafi akademik dhe studentet jane nëe komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin për zbatimin korrekt të programit.<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br>**Evideca 22 LABORATORËT**<br>**Evidenca 5.3 PLANI MËSIMOR** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Mësimdhënia në programin e studimit profesional në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përfshin tranmetimin e njohurive tëorike dhe praktikë profesionale për të përgatitur studentët për sfidat reale të fushës së tyre të punës. Stafi akademik ka një përqendrim të veçantë në përdorimin e metodave të mësimdhënies që i përshtaten nevojave të studentëve. Për të promovuar inovacionin në mësimdhënie dhe për të siguruar pajisje dhe projekte laboratorike, ofrohen trajnime nga KPT dhe ofrues të pajisjeve dhe projekteve përmes zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Zyra e IT ofron mbështetje përmes përgatitjes së materialeve në gjuhën shqipe, video tutorial-eve dhe takimeve online për të ndihmuar studentët. Gjatë gjithë vitit akademik, departamenti ofron konsulta të rregullta mes pedagogëve dhe studentëve për të adresuar nevojat e tyre. Studentët gjithashtu mund të kontaktojnë përgjegjësin e departamentit për të zgjidhur probleme të ndryshme që lindin gjatë mësimdhënies. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve. | Kolegji Profesional i Tiranës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, mbështesin personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamenit të Teknologjisë së Informacionit. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike. Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies etj. Stafi akademik inkurajohet duke u mbështetur për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të |

| | |
|---|---|
| | përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor. Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor, Departameni i Teknologjisë së Informacionit, nëpërmjet zyrës së IT ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur (1) Sistemin Interaktiv Classter (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Microsoft (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit etj. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit akademik KPT ka ndërmarë një anketë me anë të një pyetsori. Qellimi i pyetsorit është mbledhja e informacionit për qëndrimin dhe qasjen e stafit në lidhje me disa elementë të caktuar të procesit akademik, për të evituar pika/nevoja për ndryshim dhe ose përmirësim.<br>**Evidenca 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve**<br>**Evidenca 6.4 Anketa e Stafit**<br>**Evidenca 11.5 Thirrje per pjesemarrje ne projekte për stafin**<br>**Evidenca 48 Artikuj Botime promo Libri**<br>**Evidenca 46.1 Broshura Engine**<br>**Evidenca 11 Lista e Projekteve** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Në programin e studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ne KPT është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës ne KPT. Aplikanti për staf akademik testohet për kompetencat e tij përmes një leksioni të hapur. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.<br>**Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite** |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes zyrës së Alumnit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes sondazheve për vlerësimin e procesit mësimor të cilat zhvillohen në mënyrë të përseritur.<br>**Evidenca 15 Formularët e vlerësimit Studentë**<br>**Evidenca 16 Fokus Grupe** | | | |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Në KPT funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, njësi e cila është e përbërë nga Njësia e Sigurimit të Brëndëshëm të Cilësisë (NJSBC), si një njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të KPT-së. Kjo njësi vlerëson përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinon dhe bashkërendon aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike. Mënyra e funksionimit të NJSBC-së rregullohet me rregulloren e NJSBC.<br>**Evidenca 13.2 Raporti NjSBC** | | | |
| **Konkluzione** | *Kolegji Profesional i Tiranës kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë, zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| Standardi III.2<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e vlerësimit janë të përcaktuara në rregulloren e KPT-së dhe rregulloren e programit të studimit.<br><br>Mënyra e vlerësimit jepet në cdo syllabus, dhe pedagogu jep udhëzimet përkatëse në auditor në fillim të zhvillimit të lëndës.<br><br>Kontrolli i vazhdueshëm është si mëposhtë:<br>• Pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime 10%<br>• Laborator/Praktika 30%<br>• Provimi Përfundimtarë 60%<br><br>Sistemi i vlerësimit të dijeve:<br><br>Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me gërma nga F në A .<br><br>Nota më e ulët kaluese është 5 (pesë), ndërsa nota 10 (dhjetë) është maksimale në këtë sistem vlerësimi.<br><br>Për sistemin e vlerësimit të KPT, konsideron se metodologjia më e duhur për këtë proces është si vijon:<br><br>1. Tezat e provimit janë të formuluar nga titullari i lëndës dhe miratohen në departament.<br><br>2. Provimet zhvillohen me procedura sekrete, duke mbajtur emrin e studentit të fshehur gjatë vlerësimit nga pedagogu.<br><br>3. Studenti ka të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar të një lënde kur ka plotësuar detyrimet për pjesëmarrjen në atë lëndë, të përcaktuara në planin mësimor dhe rregulloren, si dhe ka shlyer detyrimet financiare ndaj institucionit.<br><br>4. Studentët që kanë të drejtën për të hyrë në provim rregjistrohen nga sekretaria në listën emerore të provimit.<br><br>5. Vlerësimi i studentit bëhet me pikë të detajuara për çdo pyetje.<br><br>6. Dorëzimi i vlerësimit të provimit bëhet brenda dy javësh nga data e zhvillimit të provimit.<br><br>7. Pedagogu dërgon çelësin e zgjidhjes së tezës përmes |

| | |
|---|---|
| | emailit ose e publikon në sekretari.<br><br>8. Nëse studenti ka ankesë për pikët e marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka kryer procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund të drejtojë një kërkesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit, duke paraqitur arsyet e ankesës së tij. Më pas, një komision Ad Hoc i përbërë nga tre pedagogë, përfshirë pedagogun e lëndës, shqyrton kërkesën dhe rivlerëson komponentin e ankimuar.<br><br>Evidenca 5.5 SYLLABUS.pdf<br><br>Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të cdo lënde studenti informohet me metodologjinë e testimit dhe vleresimit të njohurive nga pedagogu i lëndës nëpërmjet sylabusit të lëndës. Kontrolli i vazhdueshëm (format e vlerësimit të studentëve dhënë në përqindje) është si më poshtë:<br><br>• Pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime 10%;<br>• Laborator/Praktika 30%;<br>• Provimi Përfundimtarë 60%;<br><br>Gjithashtu studenti mund të marrë informacion lidhur me metodat e vlerësimit të njohurive në lëndë të caktuara nëpërmjet:<br><br>• Manualit të Studenit;<br>• Manualit Classter;<br><br>*GVJ sygjeron që në syllabus të jepet dhe Sistemi i vlerësimit të dijeve.*<br><br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS**<br><br>**Evidenca 27 MANUALI I STUDENTIT**<br><br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER** |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në | Në KPT metodat e testimit janë të ndarë në disa komponentë për të prodhur një vlerësim objektiv të studentit si më poshtë:<br><br>• Pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime 10%<br>• Laborator/Praktika 30%<br>• Provimi Përfundimtarë 60%<br><br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| teori ashtu edhe në aftësitë praktike. | | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br><br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në KPT, për studentët të cilët ndjekin programin e studimit "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" vlerësimi i përgatitjes së tyre realizohet gjatë gjithë semestrit. Kontrolli i vazhdueshëm i përfshin këto komponentë:<br><br>- Pjesëmarrja dhe angazhimi në ushtrime llogaritet 10% të vlerës së përgjithshme.<br><br>- Aktivitetet në laborator/praktika llogariten 30% të vlerës së përgjithshme.<br><br>- Provimi përfundimtar llogaritet 60% të vlerës së përgjithshme.<br><br>Këto informacione janë të paraqitura detajisht në syllabus. Kombinimi dhe peshat e këtyre komponentëve mund të ndryshojnë për lëndë të caktuara, për të përshtatur më mirë natyrën e tyre. Ndryshimet propozohen nga pedagogu i lëndës, miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe përcaktohen në syllabus.<br><br>Vlerësimi i dijeve, jepet në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë. Rezultati përfundimtar konvertohet në një shkallë notë nga 4 deri në 10, ku gërmat nga E në A janë kaluese. Detaje mbi shkallën e vlerësimit të dijeve jepen në rregulloren e programit të studimit.<br><br>*GVJ sygjeron që në syllabus të përfshihet dhe tabela e* |

| | |
|---|---|
| | *shkalles së vlerësimit të dijeve.*<br><br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | *GVJ konstaton që në KPT nuk ka një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi,* por për të shmangur format e ndryshme të abuzimit dhe rritjes së transparencës procedura e provimit realizohet me sekretim.<br><br>Sipas rregullores së KPT dhe manualit të studentit, është përcaktuar që provimet zhvillohen nën procedura sekretimi, duke ruajtur anonimitetin e emrit të studentit në fletën e provimit deri në dorëzimin e tyre nga pedagogu në sekretari.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT**<br><br>**Evidenca 27 MANUALI I STUDENTIT** |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Në KPT, për studentët të cilët ndjekin programin e studimit "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" vlerësimi i përgatitjes së tyre realizohet gjatë gjithë semestrit. Kontrolli i vazhdueshëm i përfshin këto komponentë:<br><br>- Pjesëmarrja dhe angazhimi në ushtrime llogaritet 10% të vlerës së përgjithshme.<br><br>- Aktivitetet në laborator/praktika llogariten 30% të vlerës së përgjithshme.<br><br>- Provimi përfundimtar llogaritet 60% të vlerës së përgjithshme.<br><br>Këto informacione janë të paraqitura detajisht në syllabus. Kombinimi dhe peshat e këtyre komponentëve mund të ndryshojnë për lëndë të caktuara, për të përshtatur më mirë natyrën e tyre. Ndryshimet propozohen nga pedagogu i lëndës , miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe përcaktohen në syllabus.<br><br>Vlerësimi i dijeve, jepet në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë. Rezultati përfundimtar konvertohet në një shkallë notë nga 4 deri në 10, ku gërmat nga E në A janë kaluese. Detaje mbi shkallën e vlerësimit të dijeve jepen në rregulloren e programit të studimit.<br><br>Informacioni i shkalles së vlerësimit të dijeve është dhënë në |

| | |
|---|---|
| | rregulloren e programit të studimit.<br><br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT** |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/fëdback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në KPT, stafi akademik ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët për të përmirësuar rezultatet e tyre. Vlerësimi i testimeve zakonisht shoqërohet me komente orientuese për të adresuar problematikat dhe për të rritur cilësinë e formatit të testeve. Përveç kësaj, stafi akademik mund të organizojë seanca sqaruese pasi rezultatet bëhen publike nga sekretaria mësimore.<br><br>Gjithashtu studentët në përfundim të provimit njihen dhe me celësat e zgjidhjes së provimeve.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | GVJ bazuar në dokuntacionin e vënë në dispozicion konkludon se :<br><br>1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës;<br><br>2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi;<br><br>3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës;<br><br>Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit. Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe studenti vlerësohet me notën 4. KPT për të shmangur plagjiaturën e mashtrimin, në Rregulloren e KPT përshkruan masat që merren për këtë shkelje disiplinore në detyrat e kursit, punës së laboratorit dhe punimit të diplomës.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Në rregulloren e programit të studimit "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përcaktohet qartë që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritën e studentëve.<br><br>Dorëzimi i vlerësimit të provimeve bëhet 2 (dy) javë nga data e zhvillimit të tyre.<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | STUDIMIT | | | |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në rregulloren e programit të studimit "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" përcaktohet qartë se studenti ka të drejtë për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit etj.<br><br>Kështu, nëse studenti nuk është dakort me rezultatet e vlerësimit ai ka të drejtë e ankimimit/apelimit.<br><br>Procesi kalon në disa etapa:<br><br>Se pari, pasi merr rezultatet studenti mund te sqarohet me pedagogun e lëndës lidhur me rezultatet.<br><br>Se dyti, nëse studenti vazhdon të mos jetë akoma dakort lidhur me vlerësimin, ai mund ti drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim ku të parashtrojë arsyjet mbi të cilën ai bazon ankesën.<br><br>Së treti, Pedagogu pret studentët per të sqaruar cdo pretendim të mundëshëm.<br><br>Në fund, pedagogu plotëson procesverbalin përfundimtarë në sekretarinë mësimore.<br><br>Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në KPT, për cdo kërkesë për ankimim e cila i deroghet Përgjegjësit të Departamentit, ky i fundit angazhohet në gritjen e një komisioni Ad Hoc të përbërë nga tre pedagoge, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës. Komisioni rivlerëson komponentët e ankimimit dhe në përfundim mër një vendim. Vendimi i marr nga komisioni është përfundimtar dhe dokumentohet në procesverbalin përfundimtarë të provimit.<br><br>Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | |
| **Konkluzione** | *Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit. Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.4<br><br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Strategjitë e programit professional Teknologji Informacioni dhe Komunikimi janë:<br>• Pajisjen e studentit me njohuri të thella tekniko-praktike në nivel profesional dhe praktik që kërkohen në fusha të ndryshme të TIK;<br>• Aftësim të studentëve në zgjidhjen e problemeve te TIK;<br>• Aftësim për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e sistemeve komplekse për të administruar rrjetet te kompleksitetit të ulët dhe mesëm;<br>• Aftësim për tu specializuar ne sektorin TIk sipas kërkesave të tregut të punës;<br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT**<br>**Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit "TIK"**<br>**Evidenca 46 Broshura KPT** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit social duke qënë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit.<br>*GVJ sygjeron që në kurrikulën e program të studimit të përfshihen dhe lëndë nga fusha ekonomisë, sociologjisë dhe komunikimit.*<br>**Evidenca 5.3 PLANI MËSIMOR** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo | Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit/punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit |

| | |
|---|---|
| lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara. Një mënyrë kjo për të shqyrtuar se cfarë studentët kanë kuptuar përpara se të mbyllin lëndët.<br><br>**Evidenca 5.3 PLANI MËSIMOR** |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Në KPT, procesi i mësimdhënies ofron studentëve mundësinë të zhvillojnë njohuritë e tyre nëpërmjet ushtrimeve, punës laboratorike, detyrave kursi, dhe praktikave profesionale. Çdo syllabus përcakton qëllimin e kursit në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e të nxënit.<br><br>Njohuritë praktike përputhen me aftësitë praktike, të cilat zhvillohen gjatë seancave laboratorike.<br><br>KPT mbështet mobilizimin e studentëve dhe stafit, dhe bashkëpunon me IAL për të ndërtuar projekte dhe aktivitete të përbashkëta në fusha akademike.<br><br>**Evidenca 22 LABORATORËT**<br><br>**Evidenca 10 Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet**<br><br>**Evidenca 10.2 MoU_UTh**<br><br>**Evidenca 11.3 USIA roundtable USIA**<br><br>**Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjell tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e inxhinierisë së softuerit, brënda dhe jashtë vendit. KPT organizon takime të hapura me bizneset, industrinë dhe organizatat, si në grupe ashtu edhe individuale, për të prezantuar mundësitë e karrierës për studentët brenda dhe jashtë vendit.<br><br>**Evidenca 31 TAKIME ME BIZNESE**<br><br>**Evidenca 49 Prezantimet në Departament** |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e zhvillimit TIK.* |
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Përmbushet** **Përmbushet** **Përmbushet** |

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e KPT specifikohen qartë detyrimet përmbyllese që studenti ka. Mbrojta e diplomës është detyrimi përfundimtarë për diplomimin e studentit. Mbrojtja realizohet përmes dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtarë ose mbrojtjes së një punimi Diplome për studentët me mesatare mbi 8.<br><br>Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e marrjes së diplomës.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në bashkëpunim me sekretarinë mësimore përcaktojnë orare mbi konsultime për provimet, takime sqaruese me studentët për të dhënë informacion në lidhje me mbarëvajtjen e tyre mësimore, udhëzimeve dhe këshillimeve mbi dorëzimin e laboratorëve si dhe instruksioneve mbi procedurat që studentët duhet të ndjekin për dorëzimin e dosjes së praktikës profesionale. Procesi i praktikave profesionale ndiqet nga zyra e karrierës, mbështetjes dhe informimit të studentëve në bashkëpunim me departamentitn. Studenti informohet nëpërmjet email-t për njoftime lidhur me detyrimet përmbyllese.<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT**<br><br>**Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale** |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e | Mbrojta e diplomës është detyrimi përfundimtarë për diplomimin e studentit. Mbrojtja realizohet përmes dhënies së një provimi të përgjithëshëm përfundimtarë ose mbrojtjes së një punimi Diplome për studentët me mesatare mbi 8. |
| njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ | Provimi përfundimtarë është i ndërtuar nga maksimumi pesë seksione pyetjesh përkatësisht për gjashtë lëndë të ndryshme. Rëndësia dhë pesha e secilës lëndë në provimin |

| | |
|---|---|
| modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | përfundimtarë përcaktohet në bazë përqindje dhe total pikësh të shpërndara për cdo pyetje, respektivisht për secilën lëndë të cilat ndërmerren dhe komunikohen nga Departamenti.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT**<br><br>**Evidenca 50 Programi dhe Model teze PPP** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Mbrojta e diplomës është detyrimi përfundimtarë për diplomimin e studentit. Mbrojtja realizohet përmes dhënies së një provimi të përgjithëshëm përfundimtarë ose mbrojtjes së një punimi Diplome për studentët me mesatare mbi 8.<br><br>Për here të parë në vitin akademik 2022-2023 studentët kanë mbrojtur punim diplome. Studentët të cilët mbrojtën punimin e diplomës janë udhëhequr dhe orientuar nga pedagogë udhëheqës. Stafi akademik i angazhuar për të ndihmuar studentët për të realizuar udhëheqjen e punimit të diplomës është zgjedhur me vendim rektorati.<br><br>Përzgjedhja e stafit është bërë mbi bazë të fushës së ekspertizës të secilit personel që korespondon gjithashtu me natyrën e profilit të studentëve që ju nënshtruan mbrojtjes së diplomës me temë praktike.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit. | Deri më vitin akademik 2021-2022 procesi i diplomimit është realizuar me provim të përgjithëshem. Në vitin akademik 2022-2023 procesi i diplomimit u realizua dhe me mbrojtje teme diplome për studententët me mesatare mbi 8.<br><br>Studentët të cilët mbrojnë diplomën me temë diplome në dispozicon të tyre janë të gjithë laboratoret që KPT disponon. Nese studenti ka nevojë për realizimin e testeve, analizave në ambjente me të profilizuara KPT shfrytëzon bizneset me të cilat bashkëpunon për realizimin e praktikave profesionale për tu dhënë mundësi studentëve të shkojnë atje për të realizuar projektin e temës së diplomës.<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë. | Në rregulloren e KPT është përcaktuar se Provimi i Përgjithshëm apo tema e diplomës vlerësohet me notë, njëlloj si lëndët e tjera. Në provimin e përgjithëshem përfundimtar, secila lëndë ka peshën e saj mbi bazën e krediteve përkatëse |

| | |
|---|---|
| | në vlerësimin e përgjithshëm prej 100 pikësh.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | GVJ konstaton se struktura e programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite.<br><br>Për diplomat profesionale 2 vjecare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës. Studenti pajiset me numër matrikullimi nga Qëndra e shërbimeve Arsimore. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br><br>**Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT** |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Në rregulloren e KPT dokumentacioni lidhur me të dhëna personale të studetëve regjistrohet dhe ruhet në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Dokumentacioni i procesit mësimor dhe i të dhënave të studentëve, KPT mban në formë të shkruar dhe elektoronike nëpërmjet dokumentave më poshtë:<br><br>• Regjistrin themeltar të studentëve<br>• Rregjistrin e arritjeve akademike<br>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave |
| | Pas përfundimit të studimeve nga studenti, dokumentacioni i regjistrimit të tij arkivohet dhe ruhet për një kohë të papërcaktuar. |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">Evidenca:<br>Evidenca 4 Rregullorja KPT<br>Evidenca 5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Në rregulloren e programit të studimit dhe rregjulloren e KPT përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të përgjithëshëm përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një tezë diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë profesionale 2 vjecare në profilin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
<tr><td colspan="5">Standardi III.6<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td colspan="4">Vlerësimi</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</td><td colspan="4">Në rregulloren e KPT është e përcaktuar si detyrë e Përgjegjësit të Departamentit vlerësimi i formave të reja inovative të mësimdhënies.<br>Përgjegjësi i Departamentit vlerëson metodat e propozuara duke u bazuar në zbatueshmërinë e tyre, lehtësinë e përdorimit nga studentët dhe pritshmëritë e paraqitura gjatë fazës së propozimit.<br>Sa herë që një metodë e re inovative miratohet, stafi akademik trajnohet për ti përdorur ato efektivisht në mësimdhënie.<br>Në kohën e pandemisë Covid, janë aplikuar disa nga metodat inovative në mësimdhënie.<br>Evidenca 4 Rregullorja KPT</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë</td><td colspan="4">Kolegji Profesional i Tiranes ka paraqitur në dokumentacion që harton dhe zbaton strategji për përmirësimin e</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Statutin e KPT janë dokumentuar të dhënat për zhvillimin e mësimdhënies. Insitucioni harton raporte të veprimtarive insitucionale në çdo vit akademik të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe rapotin e analizës së kërkimit shkencore. KPT ka paraqitur që ka njësi të veçantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vleresimit te Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë e cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitet e KPT.<br>Personeli Akademik vleresohet nga:<br>- Eprori Direkt<br>- Studentet<br>- Zyra e BNJ<br>- Zyra NJSBC.<br>Të gjitha format më lartë të vlerësimit realizohen nëpërmjet pyetsorëve dhe kanë për qëllim të monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.<br>Rezultatet e të gjithë anketave më sipër merren nga Përgjegjësi i Departamentit i cili merr masa për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësë se tij bazë dhe antarëve të personelit.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 13.2 Raporti NjSBC**<br>**Evidenca 15 Formularet e vlerësimit Studente**<br>**Evidenca 16 Fokus Grupe**<br>**Evidenca 6.4 Anketa e Stafit** |
| **Kriteri 3.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Në rregulloren e NJSBC percaktohet qartë që është detyrë e saj për të njoftuar drejtuesit e departamenteve lidhur me rezultatet e monitorimeve te kryera.<br>Në vijim përgjegjësi i departamentit në vartësi të rrezultateve merr masa për të përmirësuar pikat e dobëta dhe për të rritur performacën e përgjithëshme të personelit, njësisë bazë dhe intitucionit.<br>**Evidenca 13.1 Rregullore NjSBC**<br>**Evidenca 13.2 Raporti NjSBC** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | KPT ka hartuar një Politikë të Kërkimit të Aplikuar, që synon të ndihmojë dhe inkurajojë stafin akademik të marrë pjesë në seminare, konferenca, trajnime dhe aktivitete të tjera për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe akademike.<br>Në kuadër të programit të aktiviteteve dhe trajnimeve, KPT organizon leksione të hapura si një mënyrë për të ndarë përvojën dhe praktikën në mësimdhënie.<br>Këshilli i Garancisë së Cilësisë vlerëson se në KPT zhvillohen aktivitete për nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencorë.<br>**Evidenca 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve**<br>**Evidenca 19 Politika e kërkimit të aplikuar në KPT**<br>**Evidenca 19.1 Kërkimi i aplikuar**<br>**Evidenca 49 Prezantimet në Departament** |
| **Konkluzione** | *Në KPT monitorimi dhe vlerësimi i stafit akademik bëhet nga eprori direkt, nga studentët, nga zyra e BNj dhe nga NJSBC. NJSBC informon drejtuesit e departamenteve, e përmes tyre të gjithë stafin e KPT, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvillurara, me synimin e marrjes së masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njesive të tij bazë dhe antarëve të personelit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| |
|---|
| **Standardi IV.1** |
| **Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional** |

| në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave, GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Departamenti mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet cdo vit, lëndët modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për cdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale.<br><br>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ku bën pjesë programi i studimit TIK ka në përbërje:<br>• Viti akademik 2018-2019, 13 PAE (2 Prof Dr, 10 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2019-2020, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2020-2021, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2021-2022, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND);<br>• Viti akademik 2022-2023, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND).<br><br>**Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KPT, GVJ konstaton se ngarkesa mesimore e stafit akademik efektiv përcaktohet me vendim rektorati.<br><br>Për vitin akademik 2022-2023, është marr vendimi rektoratit dt.03.10.2022, nr. prot. 03 në të cilën përcaktohet ngarkesa mësimore vjetore si mëposhte:<br>• Personeli akademik 360 orë mësimore vjetore.<br>• Rektor – jo me pak se 70 orë mesimore dhe jo më shumë se 90 orë mësimore vjetore.<br>• Përgjegjës Departamenti: jo më pak se 120 orë dhe jo më shumë se 150 orë mësimore vjetore.<br><br>Ngarkesa mësimore përcaktohet në kontratën individuale të |

| | |
|---|---|
| | punës për secilin pjestar të stafit akademik efektiv.<br>• Personeli akademik mund të angazhohet në veprimtari:<br>• Mësimdhënëse<br>• Kërkim, zhvillim dhe transferim teknologjie<br>• Mbështetëse për Institucionin.<br>Evidenca 29.3 Vendim Rektor për përcaktimin e ngarkesës mësimore staf Efektiv<br>Evidenca 29.1 Dosja e personelit |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | GVJ konstaton që në KPT ka të angazhuar personel akademik, ndihëmës mësimor dhe personel administrative. Punonjësit janë të angazhuar me kontrata të kohëzgjatje të përcaktuar ose të pa përcaktuar, duke përfshirë angazhime të plota ose të pjesshme në vartësi të nevojave që KPT ka.<br>Në zyrën e burimeve njërëzore ndodhej dosja secilit antarë të stafit akademik, ndër të tjera aty ndodhej kontrata e punës e secilit punonjës. KPT siguron mbulimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të të gjithë stafit të punësuar.<br>Kur në KPT rekrutohet staf i ri, ky i fundit përzgjidhet duke konsideruar sa më poshte:<br>Gjatë procesit të rekrutimit të stafit, KPT i kushton vëmëndje të vecantë kritereve si më poshtë:<br>• Selektimi dhe përcaktimi i stafit sipas kërkesave të departamenteve.<br>• Zbatimi i të dy anëve të kontratës së punës.<br>• Kompetencave specifike dhe të përgjithshme të personelit akademik.<br>Evidenca 3 Statuti KPT<br>Evidenca 29.2 KONTRATA TIP E PUNES |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në | KPT ka harturar një Manual të Burimeve Njerezore/ Procesi i rekrutimit në të cilën përshkruhet qartë të gjitha hapat që institucioni kryen për rekrutimin e personelit të ri.<br>Procesi për një rekrutim të ri nis nga kërkesa e departamentit duke ju referuar planeve mësimore të lëndëve dhe ngarkesat mësimore të miratuara.<br>Kriteret për punësimin e personelit të plotë përcaktohen nga |

| | |
|---|---|
| përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | fakulteti dhe miratohen nga Rektori. Përzgjedhja e personelit akademik bëhet nëpërmjet konkurseve, pas vlerësimit të tyre nga një komision rekrutimi i caktuar me urdhër të Rektorit. Kandidatët vlerësohen në bazë të përmbushjes së kritereve të shpallura dhe kompetencave profesionale.<br><br>Vlerësimi i kandidatëeve bëhet mbështetur në disa kritre kyce si më poshte:<br>• Eksperienca në mësimdhënie në nivel universitar;<br>• Të ketë së paku gradën Master Profesional;<br>• Cilësia dhe standartet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universitetve perendimore;<br>• Rezultatet personale të kandidatit;<br>• Motivet kryesore për tu bërë pedagog në KPT;<br>• Aftësia komunikuese dhe Etike;<br>• Eksperienca e punësimit;<br>• Zotërimi i gjuhëve të huaja;<br>• Paraqitja gjatë intervistës;<br>• Paraqitja gjatë leksionit të hapur para departamentit përkatës (kur aplikohet)<br><br>Në strukturën e KPT-së, mund të angazhohen pedagogë pa tituj dhe grada, por me një përvojë të gjatë dhe të suksesshme në fushën e tyre, lidhur me faktin që ky është nje program studimi profesional. Aplikimet mund të dërgohen dorazi ose nëpërmjet postës elektronike në zyrën e burimeve njerëzore të KPT.<br><br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br><br>**Evidenca 29 MANUALI BNJ** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës | KPT ka të përcaktuar në Statutin e saj, vecoritë – kriteret e personelit ndihmës akademik.<br><br>Sipas tij, në KPT personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës-akademik me karakter mësimore dhe ndihmës-akademik me karakter administrative. Personeli ndihmës mësiomr përgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një komision rekrutimi ku marrin pjëse Rektori dhe Drejtues të Njësive Bazë.<br><br>*GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e* |

| | |
|---|---|
| specifike të programit të studimit. | *studimit nuk ka të angazhuar për programin e studimit personel ndihmës akademik të dedikuar për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore*<br><br>**Evidence 3 Statuti KPT**<br><br>**Evidenca 6.1 Të dhënat e stafit në vite** |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ. | Administrimi, ruajtja dhe përditësimi i dosjeve të personelit akademik dhe administrative bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave. Nga kontrolli që u bë në mënyrë rastësore i dy dosjeve rezulton që përmbajta është si më poshtë:<br><br>• CV<br>• ID<br>• Diplomë / kualifikime/Trajnime<br>• Raporti i Aftësisë për Punë/librezë shëndetësore<br>• Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh<br><br>Në fund të cdo semestri paraqitet ngarkesa e realizuar për cdo antarë stafi.<br><br>**Evidenca 29.1 Dosja e personelit** |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Në kurrikulën e programit të studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka praktikë profesionale, të cilën studentët e zhvillojnë gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë.<br><br>Studentëve të cilët ndjekin studimet e tyre në KPT u jepet mundësia të ndjekin praktikat mësimore në subjeket në të cilët KPT ka nënshkruar kontrata.<br><br>Gjatë periudhës së praktikës mesimore mes subjektit dhe KPT ka një komunikim të vazhdueshëm i cili siguron mbikqyrjen e studentit.<br><br>Marrëveshjet e bashkëpunimit që KPT ka me institucione private dhe shteterore sigurojnë jo vetën mbulimin e kuadrit akademik të studentit (sigurimin e kryerjes së praktikës mësimore) por shpeshherë dhe punënsimin e tyre.<br><br>Mund të përmendim disa subjekte që KPT ka marrveshje bashkëpunimi mund të përmendim One, Make with ICT, Albania ICT Academy,Tek 360, Bashkia Tirane, Poshta shqiptare etj.<br><br>*GVJ rekomandon KPT të punojë në rritjen e numrit të* |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">marrëveshjeve të bashkëpunimit.<br><br>Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit<br><br>Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale</td></tr>
<tr><td>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</td><td colspan="4">KPT nga ana e saj cakton një antar të stafit akademik përgjegjes për ndjekjekjen e praktikave profesionale, gjithashtu subjekti pritës cakton një person kontakti mbikqyrës për ndjekjen e studenteve që kryejnë praktikën.<br><br>Personi mbikëqyrës i subjektit pritës plotëson një formularë vlerësimi për studentin praktikant. Në përfundim të praktikës profesionale student përgatit një raport përfundimtarë për punën e kryer. Raporti mbrohet nga studentit përpara një komisioni të vecantë i cili ngrihet me vendim të përgjegjësit të Departamentit. Vlerësimi bëhet me notë.<br><br>Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">KPT ka staf të mjaftueshëm dhe kualifikuar për të përmbushur nevojat e programit të studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.2<br><br>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në</td><td>KPT ndodhet në Rrugën Xhanfize Keko, Tiranë.<br><br>Ky lokacion mund të aksesohen lehtësisht në kembë, ose me mjete të transportit pubik nga studentët, punonjësit etj.<br><br>Mjediset mësimore kanë infrastrukturë të përshtatshme dhe</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | bashkëkohore për një zhvillim normal të procesit mësimor teorik dhe praktik.<br><br>Në dispozicion të studenteve ka auditorë pëer të ndjekur leksonet, seminaret dhe laboratorë për të zhvilluar praktika lëndore.<br><br>KPT ka 4 laboratore TIk dhe laborator IOT në ndihmë të procesit mësimorë të studentëve të cilët ndjekin programin e studimit TIK.<br><br>Evidenca:<br><br>**Evidenca 34 INFRASTRUKTURA**<br><br>**Evidenca 22 LABORATORET** |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset mësimore janë të organizuara në:<br>• Klasa Leksionesh<br>• Klasa Ushtrimesh<br>• Laboratore.<br><br>Të gjithë klasat e leksioneve dhe ushtrimeve janë të pajisura me mjetet e nevojshjme IT (të tillë si internet, projektor, pc, programe) në ndihmë të procesit mësimor.<br><br>Të gjithë laboratoret janë në funksion të aftësimit praktik të njohurive teorike të fituara gjatë leksioneve. Ato janë të pajisur me kompjutera me parametra optimal për të suportuar programet software-ike bashkëkohore të nevojshme në funksion të procesit mësimorë.<br><br>**Evidencë 22 LABORATORET**<br><br>**Evidencë 34.1 INFRASTRUKTURA IT** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Në funksion të programit të studimit TIK janë katër laboratore, me 25 poste pune, me kompjutera. Në cdo kompjuter janë të instaluar programet komjuterike si më poshtë në funksion të procesit lëndor:<br>• Eclipse<br>• Notepad++<br>• Dev++<br>• Xampp<br>• Java<br>• Virtual Box |

| | |
|---|---|
| | • Raptor<br>• Packet Tracer<br>**Evidenca 22 LABORATORET**<br>**Evidenca 34.1 INFRASTRUKTURA IT**<br>**Evidenca Vizita ne Institucion** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës së kryer në IAL, GVJ konstaaton që në në funksion të programit të studimit TIK janë kater laboratore, me 25 poste pune, me kompjutera. Për sigurimin e një procesimi mësimor korrekt dhe cilësor nëpër kompjutera janë të instaluar programet profesionele të përshtatura me natyën e programit të studimit.<br>**Evidenca 22 LABORATORET**<br>**Evidenca 34.1 INFRASTRUKTURA IT**<br>**Evidenca Vizita ne Institucion** |
| **Konkluzione** | *KPT ka ambjente dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, ushtrimeve dhe laboratoreve. Në funksion të programit të studimit TIK jane 4 laboratore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në KPT, GVJ konstaton që në dispozicion të studenteve dhe stafit është biblioteka.<br>Biblioteka ofron literature bazë dhe ndihëmëse për të gjithë studentët. Ajo gjithashtu ofron dhe shërbim online nëpërmjet një game të gjëre artikujsh.<br>KPT ka një marrveshje bashkëpunimi me UET duke siguruar kështu një gamë akoma më të gjërë të artikujve në biblioteke.<br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës**<br>**Evidenca 34.4 Biblioteka online** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka e KPT është në shërbim të studenteve dhe stafit të saj për të siguruar një zhvillim të procesit mësimor dhe akademik.<br><br>Fondi i bibliotekës rritet rregullisht përmes abonimeve në biblioteka dhe revista online.<br><br>KPT ka zhvilluar një bibliotekë online me resurse mësimore dhe kërkimore duke siguruar qasje për të interesuarit edhe kur ato nuk ndodhen në ambjentet e institucionit.<br><br>Biblioteka është një aset i rëndësishëm i institucionit në shërbim jo vetëm të studentëve por dhe stafit akademik. Pedagogët në vartësi të nevojave të tyre akademike, bëjnë kërkesë tek përgjegjësi i departamentit për literaturë bashkëkohore.<br><br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës**<br><br>**Evidenca 34.4 Biblioteka online** |
| **Kriteri 3.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion konstatojë që në bibliotekë ndodhen pjesa më e madhe e literaturës bazë dhe literaturatures së rekomanduar të lëndëve që zhvillohen në programin e studimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.<br><br>Në komunikim me punonjësit e bibliotekës ato bënë me dije GVJ që fondi i bibliotekës pasqyrohet në mënyrë të vazhdueshme.<br><br>**Evidenca Vizita në IAL**<br><br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës** |
| **Kriteri 4.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka e KPT i shërben studentëvë në zhvillimin e procesit mësimorë-akademik. Fondi i bibliotekes pasurohet në mënyrë periodike nëpërmjet abonimeve në biblioteka dhe revista online.<br><br>KPT ka krijuar dhe bibliotekën online me materiale mësimore dhe kërkimore. Biblioteka është një aset i rëndësishëm i institucionit në shërbim jo vetëm të studentëve por dhe stafit akademik. Pedagogët në vartësi të nevojave të tyre akademike, bëjnë kërkesë tek përgjegjësi i departamentit për literaturë bashkëkohore.<br><br>KPT ka krijuar bibliotekën online me materiale mësimore |

| | |
|---|---|
| | dhe kërkimore të cilat janë lëshuar nën një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimin dhe rishpërndarjen nga të tjerët pa kufizime, si dhe ofron libraritë online ku institucioni është abonuar.<br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës**<br>**Evidenca 34.4 Biblioteka online** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve. | Gjatë vizitës në institucion GVJ vuri re që në ambjentet e bibliotekës ka pc, të cilat ishin të pajisura me internet, duke ofruar kështu studentëve dhe stafit mundësi për përdorimin të bibliotekës online, bibliotekave apo librarive ku institucioni është abonuar etj.<br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Ne rregulloren e Bibliotekës është përcaktuar orari i bibliotekës i cili është përshtatur sipas orarit të zhvillimit të procesit mësimorë.<br>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte nga ora 09:00-20:00 dhe te shtunën nga ora 09-17:00. Orari është afishurar dhe në ambjentet e jashtme të bibliotekës.<br>**Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës** |
| **Kriteri 7.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. | Nga vizita në bibliotekë GVJ ju bë me dije që fondi i bibliotekës është në process të vazhdueshëm pasurimi me botike fizike dhe elektronike. |
| **Konkluzione** | *KPT në dispozicion të studentëve dhe stafit ka një bibliotekë e cila ka një fond të pasur me libra, revista, artikuj shkencor* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *etj, fizik dhe online.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. | KPT nëpërmjet sistemit Classter bën të mundur menaxhimin e të gjithë informacionit të brëndëshëm duke përfshirë anën administrative dhe akademike.<br><br>Në Classter menaxhohet informacioni i cili lidhet me studentët nga rregjistrimi deri në diplomimin e tyre.<br><br>*Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si:*<br><br>Mësimet,<br><br>Orari i Sezonit të Provimeve;<br><br>Rezultatet e arritjeve akademike, etj.<br><br>*Classter përmban:*<br><br>Kartën e studentit;<br><br>Portalin e pedagogut;<br><br>Orarin Mësimorë;<br><br>E-books dhe librat elekronik të bibliotekës;<br><br>Menaxhimin e pagesave të studentëve;<br><br>Integrim me postën elektronike të stafit/studentëve;<br><br>Nëpërmjet Clasterit gjenerohen raporte të ndryshme të kërkuara nga financa dhe sekretaria mësimore.<br><br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit | KPT disponon një sistem të brëndëshëm menaxhimi dhe administrimi të informacionit i cili quhet sisteimi Classter. Ky sistem u vjen në ndihmë personelit akademik, ndihmës akademik dhe personelit administrative.<br><br>Informacion që disponohet në këtë sistem përpunohet dhe administrohet nga personeli përgjegjës i burimeve njerëzore |

| | |
|---|---|
| ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | dhe sekretaria mësimore sipas procedurave dhe regulloreve përkatëse.<br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER**<br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit, dhe ai infromativ i institucionit kanë qasje bazuar në elementët: përdorues-fjalëkalim.<br>Bazuar në privilegjet dhe hirearkinë e përdoruesit, garantohet dhe qasja në informacionet e menaxhuara.<br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | GVJ konkudon se në KPT ka një komunikim interaktiv nëpërmjet studenteve dhe personelit.<br>Ky komunikim sigurohet nëpërmjet adresave të emailit dhe sistemit Classter.<br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER**<br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Nga dukumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konnstatotn që sistemi Classter që KPT ka në dispozicion të menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative, duke sigurar kështu cilësinë e procesit mesimor dhe akademik.<br>Për drejtuesit dhe jo vetëm nëpërmjet sistemit Classter mundësohen raportim individuale me të dhëna në kohë reale për cdo strukturë, organ drejtues dhe titullarë.<br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER**<br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. | KPT ka në dispozicion të të gjithë të interesuarve faqen zyrëtare të web-it. Në faqen zyrtare të KPT-së është në dispozicion informacion për të të gjithë të interesuarit të cilit dëshirojnë të marrin informacione lidhur me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet, projeket, bashkëpunimet etj.<br>Informacioni në faqen zyrtare të KPT përditesohet në mënyrë të vazhdueshme nga personeli përgjegjës, mbështetur në Politikën e mirëmbajtjes së faqes së Internetit.<br>**Evidenca https://kolegjiprofesional.edu.al/** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Evidenca 35 Politika e Mirëmbajtjes manaxhimit të faqes së internetit** | | | |
| **Konkluzione** | *KPT disponon një sistem menaxhimi të brëndshëm funksional. Nëpermjet tij, adresave zyrtare të emailit sigurohet një komunikim interaktiv ndërmjet antarëve të stafit dhe studenteve.*<br>*Faqa zyrtare e KPT është në funksion të të gjithë të interesuarve të cilit dëshirojnë të marrin informacione lidhur me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet, projeket, bashkëpunimet etj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | KPT është institucion i Arsimit të Lartë Privat me vetë financim. Burimi kyresor i të ardhurave është tarifa e shkollimit të studenteve (vlera e së cilës është e publikuar ne faqen web). Burime të tjera përfshijene: të ardhurat nga projektet/grantet ndërkombëtare, financimi nga ortakët, të ardhurat nga shërbimet që KPT ofron për të tretë etj.<br>*KPT nuk ka ndonjë raport specifik të kostove të njesisë bazë, por ka raporte te tjera më gjithë përfshirëse lidhur me menaxhimin e financave*. KPT raporton cdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhurave financiare/bursave/fondeve kërkimore etj.<br>**Evidenca 36 Raporti vjetor** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të | GVJ konstaton se në KPT hartohet një raprot vjetor i detajuar i analizes së kostove. Në raportin vjetore jepet një analizë analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucional. Plani financiarë hartohet në nivel institucional ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat.<br>Planet janë të hartuara në nivel institucional dhe jo në nivel |

| | |
|---|---|
| programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | njesie bazë përshkak se stafi dhe infrastuktura është në dispozicion të më shume se një njësie bazë.<br>Nga cfarë raprotohet në raportin vjetorë, GVJ mund të shprehet se të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.<br>**Evidenca 36 Raporti vjetor** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në KPT zyra e financës dhe administratorit është përgjegjëse për kryerjen e funksionve administrative, ekonomike dhe financiare. GVJ konstaton se në raportet vjetore jepet një analizë analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucional. Plani financiarë hartohet në nivel institucional ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat.<br>**Evidenca 36 Raporti vjetor** |
| **Kriteri 4.** Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion, RVJ harotn raporte financiare vjetore të cilat analizojnë kostot. Nga rezultatet e tyre GVJ konkludon që institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmeri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, gjithashtu dëshmon për kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.<br>**Evidenca 36 Raporti vjetor** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të | KPT është institucion i Arsimit të Lartë Privat me vetë financim. Burimi kyresor i të ardhurave është tarifa e shkollimit të studenteve (vlera e së cilës është e publikuar ne faqen web). Burime të tjera përfshijene: të ardhurat nga projektet/grantet ndërkombëtare, financimi nga ortakët, të ardhurat nga shërbimet që KPT ofron për të tretë etj.<br>KPT nuk ka ndonjë raport specific të kostove të njesisë bazë, por ka raporte te tjera më gjithë përfshirëse lidhur me menaxhimin e financave. KPT raporton cdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhurave financiare/bursave/fondeve kërkimore etj. |

| | |
|---|---|
| programeve të studimeve. | KPT shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësine konform rregullave dhe standarteve.<br><br>Evidenca 36 Raporti vjetor |
| **Konkluzione** | *KPT është institucion i Arsimit të Lartë Privat me vetë financim. Burimet financiare përfshijnë tarifat e shkollimit, projektet/grantet ndërkombëtare, financimin nga ortakët, të ardhurat nga shërbimet që KPT ofron për të tretë etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | GVJ konstaton se KPT ka hartuar një rregullore dhe një procedurë të pranimit të studentëve.<br><br>Pranimi i studentëve në KPT ndodh në përputhje me ligjet dhe rregulativat aktuale. Numri i studentëve që pranohen në çdo program studimi përcaktohet nga kapacitetet aktuale të KPT për të siguruar një proces mësimor efikas dhe duke respektuar kuotat e aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.<br><br>Studentët aplikojnë për pranim nëpërmjet portalit U-Albania. KPT shpall emrat e fituesve duke i publikuar listën në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale. Fituesit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim.<br><br>Numri i studentëve të regjistruar në progamin TIK për 5 vititet e fundit janë:<br><br>V.A 2017-2018 : 60 studentë |

| | |
|---|---|
| | V.A 2018-2019 : 25 studentë<br>V.A 2019-2020 : 36 studentë<br>V.A 2020-2021 : 18 studentë<br>V.A 2021-2022 : 10 studentë<br>V.A 2022-2023 : 14 studentë<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | KPT ka hartuar një rregullore, në të cilën është shprehur qartë se të drejtën për të regjistruar në programet që ofron kolegji, e kanë të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, nëse plotësojnë kriteret e nevojshme.<br>Kriteret jaë si më poshte:<br>1. Zotërojnë një dëftesë pjekurie dhe listë notash<br>2. Dorëzojnë dokumentat e nevojshëme për lidhjen e kontratës me KPT<br>3. Plotësojnë kriteret e pranimit që KPT ka vendosur<br>4. Shtetasit shqiptarë të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në Mas.<br>5. Kryejnë pagesën e tarifës vjetore sipas kontratës ndërmjet KPT dhe Studentit.<br>Për pranimin e kandidatëve nuk është kusht mesataria, meqënsë KPT është institucion i Arsimit të Lartë Professional.<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Kriteret për pranimin e studenteve përcaktohen nga senati akademik, cdo fillim viti akademik.<br>Kriteret e pranimit janë të publikura në faqen zyrtare të KPT dhe në ambjetet e KPT.<br>**Evidenca E 23 VENDIMET SA**<br>**Evidenca https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/**<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 4.** Kriteret, | Bazuar ne dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe |

| | |
|---|---|
| procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | vizitave në KPT, GVJ konkludon se KPT ka procedura të mirë përcaktuara dhe organiuara lidhur me pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimit përgjatë kursit, transferimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Të gjitha informacionet më lartë janë të bëra publike për studentëet në faqen web, në monitorët e kolegjit etj.<br><br>KPT organizon një javë orientimi ku ofrohen informacione për sistemin e studimeve, vlerësimin, rregullat dhe procedurat administrative.<br><br>Kolegji organizon një javë orientimi në të cilën ofrohen informacione për sistemin e studimeve, vlerësimin, rregullat dhe procedurat administrative.<br><br>Bazuar në procedurat e komunikimit në KPT, informacioni transmetohet përmes këtyre formatave:<br>1. Organizimi i takimeve informuese me nxënësit e shkollave të mesme.<br>2. Organizimi i tryezave të rrumbullakta me qëlim informues në ambjentet e KPT.<br>3. Fletëpalosjeve.<br>4. Daljet mediatike.<br>5. Pjesmarjes në panaire.<br>6. Faqes web zyrtare te kolegjit dhe rreteve sociale.<br><br>**Evidencë 30 JAVA E ORIENTIMIT**<br><br>**Evidencë 5.5 SYLLABUS** |
| **Kriteri 5.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | *GVJ nuk ka informacion konkret nëse KPT ka politika të vecanta lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të vecanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.*<br><br>Nga vizita dhe GVB, GVJ konstaton që Kolegji Profesional Tiranes ka infrastructure dhe mjedise të pershtatshme për kandidatët me aftësi të vecanta. KPT ka miratuar rregulloren për studentët me aftësi ndryshe dhe ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori studentësh përsa i përket zhvillimit të procesit akademik dhe nevojave personale si dhe ka në planet e tij përmirësimin e vazhdueshëm të këtij shërbimi.<br><br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton | Institucioni arsimor KPT ofron mundësi të ndryshme lidhur |

| | |
|---|---|
| politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | me bursat dhe finacimmet. Në KPT ofrohet burse për studentet me mesatare të lartëe te matures shteterore dhe per studentet me rezultate të larta në KPT.<br><br>Nëperrmjet webit, email, rrjeteve sociale, njoftimeve në monitoreve e ambjenteve të kolegjit mundësohet ndarja e informacioneve të ndryshme mbi mundësinë për bursa apo financime si psh Bootcamp i sipërmarrjes, Connect IT projet i GIZ dhe Bashkimit Europian, etj.<br><br>**Evidenca 39 Connect IT Bootcamp**<br><br>**Evidenca 38 Praktika Connected through Mobility** |
| **Konkluzione** | *KPT ka një rregullore dhe procedurë në të cilën shprehet qartë procedura e pranimit, regjitrimit, transfermit dhe diplomimit. Te gjitha kriteret për veprimet më sipër janë të afishuara në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale te KPT.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | KPT vë në dispozicion informacion të mjaftueshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Të gjitha të dhënat më lartë janë të përcaktuara në rregulloren, statutin dhe janë të regulluara me politika dhe procedura të ndryshme.<br><br>Për të siguruar që studentët të kenë qasje në informacion, KPT ka themeluar disa zyra me detyra specifike si vijon:<br><br>Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informacionit ofron informacion për programet e studimit të KPT-së.<br><br>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave dhe Sekretaria Mësimore mbikëqyrin punën e stafit akademik dhe studentëve dhe ofrojnë informacion relevante.<br><br>Faqja e internetit përmban informacion të plotësuar dhe të përditësuar rregullisht në lidhje me pranimet e studentëve, progresin akademik, strukturën dhe organizimin e KPT-së, |

| | |
|---|---|
| | programet mësimore, stafin, shërbimet, ofertat akademike, dhe të tjera.<br><br>KPT organizon eventin "Open Days në KPT" për të ftuar maturantët të vizitojnë ambientet e KPT-së.<br><br>KPT është pjesëmarrës e rregullt në panairin "Work and Study" për të promovuar ofertën e tij akademike.<br><br>Për realizimi e komunikimit përdoren adresat zyrtare të email që KPT u ka vënë në dispozicion stafit akademik dhe studentëve.<br><br>Në dispozicion të përmirësimit të komunikimit dhe marrjes së informacionit nga të gjithë palët e interesuara KPT ka zhvilluar sistemin Cluster. Nëpërmjet këtij sistemi realizohet një komunikim ndër aktiv mes njësive të KPT, studentët marrin informacione të ndryshme të tilla si, mësimet, orari i sezonit të provimeve, rezultatet e provimeve, materiale mësimore etj.<br><br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br><br>**Evidenca 24 POLITIKAT E KOMUNIKIMIT**<br><br>**Evidenca 28 MANUALI CLASSTER**<br><br>**Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati**<br><br>**Evidenca 37 POLITIKA E INTERNETIT**<br><br>**Evidenca 24.2 OPEN DAYS NE KPT**<br><br>**Evidenca 24.4 Panairet Work and Study Panairi House of Europe**<br><br>**Evidenca 24.1 TURET** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. | KPT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Ky informacion iu bëhet i ditur studentëve nëpërmjet:<br><br>• Këshillimit me stafin akademik;<br>• Kontakteve me zyrën e Informacionit të Studentëve;<br>• Regullores së KPT-se;<br><br>Kontratës së nënshkruar me KPT në momentin e regjistrimit.<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e | Në rregulloren e KPT është përcaktuar mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. |

<table>
<tr><td>vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</td><td colspan="4">Ky informacion ndodhet dhe në sylabusin e lëndës, të cilin pedagogu ja vë në dispozicion studentitt orën e parë të semestrit.<br><br>Evidenca 4 Rregullorja KPT<br><br>Evidenca 5.5 SYLLABUS</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</td><td colspan="4">Procedurat për modalitetin, vlerësimin e studenteve dhe diplomimet janë të përcaktuara qartë në rregulloren e KPT.<br><br>Për tu diplomuar studentët, duhet që në fund të studimeve të tyre të realizohet mbrojtja e tezës.<br><br>Mbrojtja bëhet nëpërmjet paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies se një provimi përfundimtarë, sipas Vendimit të Rekoratit i cili merret cdo vit.<br><br>Evidenca 4 Rregullorja KPT</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</td><td colspan="4">KPT ka hartuar një politikë komunikimi e cila siguron një komunikim transparent, të vërtetë, plotë dhe qartë. KPT nëpërmjet strukturave të vëna në dispozicion siguron një informim të studentëve të rinjë nëpërmjet aktiviteteve dhe eventeve të ndyshme të organizuara në mënyrë periodike si janë:<br><br>• Open days KPT<br>• Turet<br>• NASA Hackathon<br>• Java Orientuese<br>• Studentet marrin informacione nëpermjet:<br>• Sistemit Classter<br>• Emailit<br>• Kalendarit Akademik<br><br>Evidenca 4 Rregullorja KPT<br><br>Evidenca 24.2 OPEN DAYS NE KPT<br><br>Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">KPT vendos në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së</td><td>Nuk</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td></tr>
</table>

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Cdo fillim viti akademik, javën e parë KPT organizon ditët orientuese, gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrative dhe zyra e kordinimit dhe mbështetjes së studentëve janë në dispozicion të studentëve për ti informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarvajtjen e studimeve të tyre të tilla si:<br>✓ Kalendari akademik<br>✓ Orari mesimor<br>✓ Frekuentimi<br>✓ Ambjentet mesimore<br>Informacion i detajuar sa më sipër jepet dhe në faqen web të universitetit.<br>**Evidenca 37 POLITIKA E INTERNETIT** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në orën e parë të leksionit në cdo fillim të semestrit, nga pedagogu i lëndës, studentit i vihet në dispozicion sylabusi i lëndës.<br>• Nëpërmjet sylabusit, studenti informohet me:<br>• Përmbajten e lëndës<br>• Organizimin e lëndës (Leksione/seminare/ushtrime)<br>• Literaturën bazë dhe literaturën e rekomnaduar<br>• Frekuentimin<br>• Mënyrën e Vleresimit<br>Informacionet më sipër meren edhe nëpermjet Sistemit Institucional Classter. Manuali i studentit e prezanton studentit me informacionet kryesore në lidhje me jetën e tij studentore.<br>**Evidenca 5.5 SYLLABUS** |

| | |
|---|---|
| | **Evidenca 27 MANUALI I STUDENTIT**<br><br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | KPT ofron disa mënyra lidhur me informimin e studenteve mbi mundësitë e punësimit:<br><br>• Nëpermjet zyrës së Karrieres, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve.<br>• Nëpërmjet panairit të punës<br>• Nëpërmjet pedagogeve<br><br>Njoftimet për punësim publikohen në faqen e internetit të KPT, në rrjetet sociale të KPT, ju dërgohen studentëve nëpërmjet email-it si dhe shfaqen në ekranin e madh të hollit në katin e parë. KPT është në kontakt të vazhdueshmëm me biznese apo industri të ndryshme në lidhje me ofrimin e mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në KPT. Gjithashtu KPT organizon takime të hapura me biznese në grupe dhe individuale për të promovuar mundësitë e karrierës pranë tyre për studentet e KPT.<br><br>**Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit**<br><br>**Evidenca 18.1 Panairi i punës ne KPT**<br><br>**Evidenca 44 Thirrje Njoftime Punësimi**<br><br>**Evidenca 21 TRAJNIME STUDENTE** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentet të cilët ndjekin studimet në KPT marrin informacion lidhur me orarin, organizimin e procesit mësimorë, infrastrukturën etj, nëpërmjet:<br><br>• Sekretarisë Mësimore;<br>• Sistemit Classter;<br>• Email-t;<br>• Web faqes;<br>• Ditëve te orientimit;<br>• Fotove dhe videove që transmetohen në monitorët informues të hollit;<br><br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER**<br><br>**https://kolegjiprofesional.edu.al/** |
| **Kriteri 5.** Institucioni informon studentët mbi | KPT ka hartuar një rregullore të praktikës profesionale. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Nëpërmjet saj studenti njihet me:<br>• Objektivin e realizimit të praktikës<br>• Qëllimin e Praktikës Profesionale<br>• Mënyrën e Organizimit<br>• Subjektet Pritese (vendin ku do të kryej praktikën)<br>• Zhvillimin e Praktikës<br>• Vlerësimin<br>të praktikës profesionale në kuadër të programeve të studimit me natyrë profesionale.<br>KPT bashkëpunon me disa subjekte publik dhe privat dhe ofron mundësi punësimi, të cilat u vihen në dije studentëve nëpërmjet komunikimeve me email, faqes web etj.<br>**Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale**<br>**Evidenca 33 Lista e partnerëve marrëveshjeve të bashkëpunimit** | | | |
| **Konkluzione** | *KPT ka krijuar ura komunikimi dhe informon studentet lidhur me përmbajtjen e kurrikulës, orarin, organizimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, praktikën profesionele dhe mundësitë e punësimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore mbahet rregjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit. KPT mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët e c'rregjistruar në zyrëen e burimeve njerëzore dhe kontratave nëpërmjet sistemit Classter.<br>**Evidenca 45 Regjistri baze themeltar** |

| | |
|---|---|
| sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | **Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike**<br><br>**Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave**<br><br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 2.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore mbahen rregjistrin themeltarë, ku janë të regjistruar stundentët në vite, stundetët e regjistruar për here të parë dhe studentët e transferuar.<br><br>Në rregjistër hidhen të gjithë të dhënat në lidhje me progresin e studentëve, që nga pranimi deri në diplomimin, ata që janë larguar apo ata që përsërisin vitin. Ndërsa në formë elektronike të dhënat e studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit Classter.<br><br>**Evidenca 28.1 SISTEMI CLASSTER** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Në KPT bëhen kontrolle të vazhdueshme në të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacionin dhe evidencat përkatëse, që lidhin procesin mësimor dhe veprimtarinë e studentëve.<br><br>KPT përfshin dhe ekspertë të jashtëm në vlerësim e aspekteve të ndryshme të aktivitetit të tij, si për shembull në kurrikula / programe studimi etj.<br><br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br><br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT** |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Institucioni në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të tyre.<br><br>Rezultatet e të cilave analizohen, dhe nëse vihen re problematika, ndërmeren masa për përmirësimin e tyre.<br><br>**E 6.6 Raporti i cilesise se studenteve** |
| **Konkluzione** | *Në sekretarinë mësimore mbahet informacion lidhur me numërin e studentëve që janë të regjistruar stundentët në vite, stundetët e regjistruar për here të parë dhe studentët e* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *transferuar, të diplomuar etj. Informacion menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit Classter.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | KPT përfshin studentët në organet vendimmarrese dhe këshilluese nëpërmjet:<br>1. përfshirjes së përfaqësuit të studentëve në mbledhjet e departamentit.<br>2. Përfshirjes së përfaqësuesit të studentëve në grupet e vlerësimit të brendëshëm të programve të studimit.<br>3. Ngritjes së organit të Këshilit Studentorë<br>4. Angazhimit të kryetarit të këshillit studentorë në Senatin Akademik.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | GVJ organizoj takimin me studentët, dhe arriti në konkluzionin që organizmat studentorë janë funksional dhe studentët nëpërmjet tyre përcjellin zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese të kolegjit, departmentit, fakultetit, senatit akademik.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/**<br>**Vizita ne institucion** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të | Duke qënë se studentët janë të përfshirë në disa organe drejtuese dhe vendim marrese drejtuese nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Këshillin Studentorë, Bordin e Administrimit, komisionin e vlerësimit të brëndëshëm, mbledhjet e departamenit kështu studentët mund të përcjellin |

| | |
|---|---|
| studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese të departmentit, fakultetit, senatit akademik.<br>**Evidenca 3 Statuti KPT**<br>**Evidenca 6.4 Anketa e Stafit**<br>**Evidenca 15 Formularet e vlerësimit Studente**<br>**Evidenca 16 Fokus Grupe**<br>**https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita në institucion dhe takimi me studentët GVJ u bë me dije se studentët kanë të drejtë të njihen me tezën e provimit pas korigjimit pasi bëhet dhe c'sekretimi i tyre. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësim total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një formulari kërkesë me shkrim e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit brënda 48 orëve nga shpallja e rezultateve.<br>Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyje të përmendura më lartë, dekani i fakultetit ngre një komision ad hoc në përbërje të cilit bëjnë pjesë dhe pedagogët të cilët kanë korigjuar provimin. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brënda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet process-verbalit të provimit (fletës së provimit)<br>Evidenca:<br>**Evidenca 42 FORMULAR KERKESE** |
| **Konkluzione** | *Studentët në KPT janë të angazhuar në vendimmarrje dhe organet drejtuese nëpërmjet perfaqësimit të tyre në Këshillin studentorë, Bordin e Administrimit, komisionin e vlerësimit të brëndëshëm, mbledhjet e departamenit etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6** |
|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga** |

| studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në KPT janë:<br>• Departamenti, Sekretaria mësimore<br>• Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave<br>• Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve<br>• Konsultimet me pedagoget<br>**Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati** |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Nga takimi me studentët, GVJ doli në konkluzionin që studentët kanë në dispozicion të tyre mudësi të ndyshme informimi dhe këshillimi për ndjekjen dhe përparimin e studimeve të tyre. Në dispozicion të tyre janë:<br>• Departamenti, Sekretaria mësimore<br>• Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave<br>• Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve<br>• Konsultimet me pedagoget<br>**Evidenca 17.1 Rregullore Tutoriati** |
| **Kriteri 3**. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Këshillimi i karrierës sigurohet nga Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve duke informuar në mënyrë të vazhdueshme studentët mbi mundësitë e punësimit, organizimit të aktiviteteve të ndryshme orientuese dhe këshilluese, argëtuese, mbështet studentët në aplikimet e tyre, suporton studentët në aplikime punësimi etj.<br>**Evidenca 4 Rregullorja KPT**<br>**Evidenca 41 Emailet njoftuese nga koordinatoret**<br>**Evidenca 42 FORMULAR KERKESE** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna | Nga vizita ne institucion GVJ konstaton që Zyra e Karieres Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve është përgjegje për punësimin e studentëve të diplomuar. Po ashtu, zyra ka kontakte dhe lidhje të vazhdueshme me shumë institucione |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | për të zhvilluar praktikat profesionale dhe për të krijuar mundësi punësimi për studentët e Kolegjit të Pushtetit të Lartë (KPT). Alumni është i përfshirë në faqen e internetit të KPT-së në seksionin e Alumni-së dhe raportin vjetor të veprimtarisë së KPT-së.<br><br>**Evidenca 12 Sondazhi Alumni** | | | |
| **Konkluzione** | *Në KPT në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në KPT janë: Sekretaria Mësimore, Departamenti, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët, Zyra e Karrierës Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve, Konsultimet me pedagoget etj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Profesional i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike e duhur në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
3. Personeli akademik me përvojë në mësimdhënie dhe në fushën e shkencave kompjuterike;
4. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit është në përputhje me fushën e ekspertizës së personelit akademik;
5. Fondi i bibliotekës është pasuruar me tekste e literaturë të re në funksion të programit të studimit.
6. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja me partnerë ndërkombëtare për të mundësuar mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.

**Pika të dobëta**

1. U evidentuan shmangie në përqindjen e lejuar të krediteve sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, në planin mësimor, për lëndët ndërdisiplinore dhe detyrimet përmbyllëse.
2. Në programin e studimit nuk ka të angazhuar personel ndihmës akademik të dedikuar për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.
3. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit.

**Rekomandime**

1. Të përcaktohen kreditet sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, brenda % së lejuar për të gjithë komponentët e planit mësimor të programit të studimit.
2. Të realizohet një studim i mirëfilltë në tregun e punës të fushës së programit të studimit për të përmirësuar më tej këtë program studimi dhe për tiu përshtatur kërkesave dhe nevojave të reja të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
3. Të rinovohen disa nga marrëveshjet aktuale me IAL-të të cilave u ka përfunduar afati ose janë të hershme.
4. Të rritet numri i krediteve për laboratorët në disa lëndë të rëndësishme për përgatitjen profesionale të studentëve në këtë program studimi.

5. Të përditësohet literatura e detyrueshme për të gjitha lëndët e programit të studimit;

6. Të përfshihen në kurrikulën e program të studimit dhe lëndë nga fusha ekonomisë, sociologjisë dhe komunikimit.

7. IAL të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik, kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.

**Conclusions of the Evaluation of the professional study program "Information and Communication Technology" of Institution of Higher Education "Professional College of Tirana"**

**Strengths and affirmations**

1. The convenient premises and appropriate didactic infrastructure available to the study program provides the necessary contemporary spaces and conditions for the education process.
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of UAMD and the economic development of the country and meets the labor market needs, in accordance with the strategic goals of national economic development;
3. Academic personnel with experience in education and computer science field;
4. The handling of study program courses with academic personel is in compliance with field of academic personnel expertise.
5. The library fund has been enriched with new texts and literature in function of the study program.
6. The institution has signed new cooperation agreements with international partners to enable the mobility of students and academic staff.

**Weak Points**

1. Deviations were noted in the permissible percentage of credits according to Decision No. 185, dated March 25, 2021, in the curriculum for interdisciplinary courses and concluding requirements.
2. The study program does not have dedicated academic support staff for the implementation of laboratories and teaching practices.
3. The required literature for the study program in some subjects is older than 5 years.

**Recommendations**

1. Allocate credits according to Decision No. 185, dated March 25, 2021, within the allowed percentage for all components of the study program's curriculum.
2. Conduct a thorough study of the job market in the field of the study program to further improve this study program and to adapt it to the new demands and needs of the national and international job market.
3. Renew some of the current agreements with Higher Education Institutions (HEIs) that have expired or are outdated.
4. Increase the number of credits for laboratory courses in key subjects essential for the professional training of students in this study program.
5. Update the mandatory literature for all subjects in the study program.
6. Incorporate courses from economics, sociology, and communication into the study program curriculum.
7. The HEI should develop and publish specific criteria annually, before each academic year, for selecting candidates with special abilities, minorities, and marginalized groups.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |